

VENDIM
Nr. 828, datë 12.10.2020

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË
BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTIT
ARSIMOR, SHKOLLA 9-VJEÇARE “GJON GJONAJ”, NJËSIA ADMINISTRATIVE
LAÇ, BASHKIA KURBIN, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KURBIN SI NJËSI
ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të objektit arsimor, shkolla 9-vjeçare “Gjon Gjonaj”, Njësia Administrative Laç, Bashkia Kurbin, në vlerën 199 602 139.60 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind e dy mijë e njëqind e tridhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë) lekë.

2. Caktimin e Bashkisë Kurbin si njësi zbatuese për rindërtimin e objektit arsimor, shkolla 9-vjeçare “Gjon Gjonaj”, Njësia Administrative Laç, Bashkia Kurbin.

3. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i miratuar në buxhetin e vitit 2020, i transferohet Bashkisë Kurbin, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

4. Fondet e mbetura të papërdorura pas përfundimit të procedurave të prokurimit në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin “Fondi për rindërtim”, të buxhetit të shtetit.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe